



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) nenit 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafët 2.1 dhe 6, dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal nr.04/L-010, dhe neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4, nenit 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, miratoi këtë,

VENDIM PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL

Neni 1

Miratohet Kërkesa - Nisma e Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal të Komunës së Podujevës me Komunitat;

- Komuna e Prishtinës,
- Komuna e Lipjanit,
- Komuna e Fushë Kosovës,
- Komuna e Graçanicës dhe
- Komuna e Obiliqit

Neni 2

Qëllimi i themelimit të bashkëpunimit ndër-komunal sipas këtij vendimi është bashkërendimi i aktiviteteve mes 6 Komunave fqinje në sfera të ndryshme me interes të përgjithshëm në ngritjen e mirëqenies sociale sa i përket ushtrimit më efikas dhe më efektiv të kompetencave vetanake, me theks në fushat; Mirëqenie Sociale, Shërbime Publike, Sport, Kulturë, Arsim, Shëndetësi, dhe Bujqësi.

Neni 3

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciproke dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik, ofrimit të shërbimeve publike si dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Neni 4

Kryetari i Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me Komunitat e cekura dhe përgatitjen e propozim Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0008886/23
Podujevë, datë, 31 janar 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha